



NUMRI i 25-të

## Në këtë numër:

### Artikulli 1.

Vlerësimi rajonal i pjesmarrjes së të rinjve



### Artikulli 2.

Parlamenti Rinor Shqiptar: Zgjedhjet e Pranverës do të sigurojnë një zë më të fortë të të rinjve



### Artikulli 3.

Troç: Bërja e pyetjeve të vështira rreth të ardhmes së Shqipërisë



### Artikulli 4.

Fëmijët shqiptarë shfaqin krijimtari në kalendarin e tyre të vitit 2006



### Artikulli 5.

Parlamenti Rinor dhe Troç diskutojnë vlerat e kulturës shqiptare



## Vlerësimi rajonal i pjesmarrjes së të rinjve

Zyra Rajonale UNICEF-it në Gjenevë ka bërë një vlerësim të angazhimit të të rinjve në Europën Lindore duke filluar që nga viti 2004. Vlerësimi studion domethënien e pjesmarrjes së të rinjve në programet e sponsorizuara nga UNICEF-i si dhe pasqyron perceptimet e të rinjve lidhur me angazhimin e tyre. Një raport i fundit mbi vlerësimin i jep mundësinë UNICEF-it, organizatave që i shërbejnë të rinjve, si dhe vetë të rinjve të kuptojnë se si e shikojnë rolin e tyre të rinjtë në shoqëri dhe se si të sigurojnë që zëri i të rinjve të vazhdojë të dëgjohet.

Per te matur angazhimin e të rinjve, UNICEF-i angazhoi rreth 250 të rinj dhe të rritur nga Europa Lindore, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Pjesmarrësit u anketuan, u intervistuan dhe u angazhuan në aktivitete të tilla si pikturime, tregime ndodhish, dhe grupe diskutimi për të përshkruar sa më mirë përvojat e pjesmarrjes së tyre. Konstatimet kryesore të UNICEF-it në Shqipëri përfshijnë si më poshtë:

- Pjesmarrja në programet rinore parandalon sjelljet me rrisht të lartë dhe, rrjedhisht, të rinjtë janë të përgatitur më mirë për jetën. Të rinjtë gjejnë vlera në aktivitetet që janë argëtuese dhe që zhvillojnë njohuritë, aftësitë ose të kuptuarit kulturor të tyre.
- Programet dhe forumet i japin të rinjve një mundësi që të sjellin ndryshime dhe të shprehin opinionet e tyre. Parlamenti Rinor Shqiptar i mbështetur nga UNICEF-i i bën rregullisht presion qeverisë në funksion të politikave të rëndësishme për të rinjtë dhe emisioni i të rinjve Troç u krijon mundësinë të rinjve të ngrenë zërin për problemet që ato kanë në një audience kombetare.
- Të rinjtë janë pjesë integrale e koalicionëve të qeverisë dhe të shoqërisë civile të cilët mbrojnë të rinjtë. Për shembull, të rinjtë bëjnë pjesë në komitetet drejtuese dhe në bordet këshillimore, duke përfshirë atë që i paraqiti publikisht qeverisë të zbatonte Konventën e të Drejtave të Fëmijës.
- Organizatat tregojnë kapacitete më të forcuara lidhur me planifikimin dhe zbatimin e programeve rinore.
- Parlamenti Rinor Shqiptar, TROÇ dhe Shërbimet Miqësore për të Rinjtë po shërbejnë si modele për qeverinë dhe për organizatat e shoqërisë civile për të nxitur pjesmarrjen e të rinjve në shoqëri.



Parlamentarët e rinj në Ndërtesën e Kuvendit Popullor në mbledhjen vjetore me Ministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

## Parlamenti Rinor Shqiptar: Zgjedhjet e Pranverës do të sigurojnë një zë më të fortë të të rinjve

“Parlamenti Rinor Shqiptar është një vend ku të rinjtë po ndryshojnë gjërat,” shprehet Endri Shabani, Kryetari i Parlamentit Rinor Shqiptar, “Njerëzit, me të vërtetë, na dëgjojnë.”

Parlamenti Rinor Shqiptar u krijua për të angazhuar dhe për të inkurajuar të rinjtë në Shqipëri për të marrë rol aktiv në tranzicionin drejt demokracisë. Me mbështetjen e UNICEF-it, Parlamenti Rinor u krijua në vitin 2000 në Shkodër dhe në Gjirokastrë. Që nga ajo kohë, ai është zgjeruar duke mbuluar 12 prefekturat në Shqipëri. Aktualisht 480 parlamentarë të rinj diskutojnë dhe ndërmarrin veprime në funksion të çështjeve që lidhen me shkollën e tyre, me komunitetin dhe me kombin.

Parlamenti Rinor përfshin të gjithë të rinjtë shqiptarë të moshës 14-18 vjeç – jo vetëm të atyre në shkollë – të cilët kërkojnë të përmirësojnë pjesmarrjen e të rinjve në debatet publike dhe të lidhin të rinjtë me procesin demokratik. Ata që angazhohen behën të aftë në udhëheqje dhe fitojnë njohje për demokracinë në Shqipëri. Mbi të gjitha, Parlamenti Rinor përfaqëson zërin dhe mundësinë e të rinjve për të çuar përpara kauzat rinore, të cilat shpeshherë injorohen nga qeveritarët.

Gjatë pesë viteve të ekzistencës së tij, Parlamenti Rinor ka arritur shumë suksese. Lidhur me këto arritje, ai është përgjegjës për sa më poshtë vijon:

- Ka bërë lobing pranë qeverisë qendrore për të rritur shumën e financimit për arsimin nga 2.7% në 3.2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.
- Ka organizuar parandalimin e ndërtimit të një vendi për grumbullimin e mbeturinave në Tiranë, i cili do të përbente një rrezik për ambientin e komuniteteve aty pranë, me anë të peticioneve dhe të bashkëpunimit me organizatat e tjera.
- Ka organizuar veprimtaritë për ndalimin e ndërtimit të një termocentrali në zonën turistike bregdetare afër Vlorës.

Për më tepër, Parlamenti Rinor i ka dorëzuar qeverisë Strategjinë për Rininë. Raporti përçonte udhëzime të veçanta lidhur me mënyrën se si qeveria mund të trajtojë çështjet e të rinjve. Pas mungesës së zbatimit të

kësaj strategjie nga ana e qeverisë, të rinjtë parlamentarë paraqitën Planin Rinor të Zbatimit - një udhëzues i llojit hap-pas-hapi për mënyrën se si qeveria mund të vërë në veprim Strategjinë për Rininë.

Përveç progresit të madh, Parlamenti Rinor është përballur edhe me sfida. Një përpjekje ka qenë lufta për të bindur skeptiket lidhur me faktin që Parlamenti Rinor nevojitej dhe mund të sillte ndryshimin. Madje kishte edhe disa të rinj që ishin dyeshues lidhur me atë se sa i efektshëm mund të ishte Parlamenti Rinor. Por të rinjtë morën pjesë në zgjedhjet për Parlamentin Rinor vit pas viti dhe kjo pjesmarrje është rritur. Pavarësisht nga mosbesimi fillestar lidhur me zërin e bashkuar të të rinjve, sot Parlamenti Rinor e ka treguar veten si një forcë legjitime për reformë në Shqipëri.

“Kur ata e vunë re se gjërat po ndryshonin” shprehet Endri, “të rinjtë, të cilët ishin skeptikë në fillim, kërkuan se si ata mund të bëheshin pjesë e Parlamentit Rinor.”

Parlamenti Rinor po përgatitet për zgjedhje këtë pranverë. Krijimi i vendeve, e në mënyrë të veçantë për të rinjtë e minoriteteve etnike dhe femrave të reja, do të krijojë hapësirë për një zë më të gjërë në Parlamentin Rinor. Ristrukturimi është dëshmi e vlerës së Parlamentit Rinor si një rrugë e të rinjve për të bërë ndryshimin e vërtetë. Për të siguruar zgjedhje të mira, parlamentarët e rinj kanë qenë të angazhuar me marrjen e kontakteve me donatorët vendorë për financime. Mbështetja nga bizneset dhe organizatat ndihmon, gjithashtu, për të tërhequr vëmendjen në funksion të asaj që përfaqëson Parlamenti Rinor.

Në kuadrin e rritjes së ritmit, Parlamenti Rinor kërkon të synojë më lart në vitet e ardhshme.

Endri parashikon një zë më të fortë të të rinjve sapo të përfundojnë zgjedhjet. Ai shpreson se kjo do të ndihmojë në rritjen e presionit ndaj qeverisë për të aprovuar Strategjinë për Rininë. Nëse ky parashikim do të dalë i vërtetë, Parlamenti Rinor do të garantojë një të ardhme më të mirë për të gjithë të rinjtë në Shqipëri.

“Ne do të jemi gjithnjë këtu,” shprehet Endri, “për të mbrojtur të rinjtë dhe interesat e tyre.”



## Troç: Bërja e pyetjeve të vështira rreth të ardhmes së Shqipërisë

Telenovelat, aktivitetet sportive kombëtare dhe emisionet e lojrave të fatit milion-dollarëshe shpërndajne valët kudo në botë. Ka një program, sidoqoftë, që e veçon Shqipërinë dhe që është bërë krenaria e një vendi në tranzicion. Troç ose "Të Flasësh Hapur" është emisioni televiziv rinor për të rinjtë i drejtuar nga të rinjtë.

Emisioni e ngre standardin mbi atë se si realizohet gazetaria televizive në Shqipëri dhe të gjithë reporterët janë të moshës nën 18 vjeç. Troç-i është i pari i llojit të tij si një program kombëtar me lajme dhe pikpamje nga 11 qendrat në të gjithë Shqipërinë.

Troç është një program televiziv ku diskutohen në mënyrë të guximshme çështje të ngutshme kombëtare në një vend ku media ka qenë e censuruar për 45 vjet. E gjitha kjo është përmbushur nga të rinjtë të cilët nuk kanë frikë të bëjnë pyetje të vështira, dhe si rrjedhojë ata po krijojnë një ndryshim pozitiv.

"Të rinjtë kërkojnë thjeshtë t'u dëgjohej zërat e tyre" shprehet Catharine Way, përgjegjëse e zyrës së Komunikimit- UNICEF "dhe kjo është arsyeja e saktë se përse UNICEF-i dhe Televizioni Publik Shqiptar (TVSH) krijuan së bashku Troç-in". Episodi i parë i emisionit u shfaq në Shkurt të vitit 2001. Sot, më shumë se kurrë, është koha për të dëgjuar këta zëra të rinj. Shumë probleme po prekin brezin pasardhës të shqiptarëve (42% e të rinjve janë nën moshën 19 vjeç), siç janë : sfidat në sistemin e arsimit, niveli i lartë i papunësisë dhe pesimizmi për mundësitë e ardhmes. Shpesh çështjet e të rinjve nuk merren parasysh ose injorohen nga publiku i përgjithshëm duke përfshirë edhe qeverinë dhe median. Për t'i bërë problemet më alarmante, pjesmarrja e të rinjve në procesin e tranzicionit është e ulët.

Troç-i ka nisur të angazhojë të rinjtë për të sjelle në vëmendje çështjet e të drejtave të fëmijëve. Të rinjtë vullnetarë variojnë nga moshë 13-18 vjeç, dhe ata janë përgjegjës për një pjesë të madhe të prodhimit të emisionit. Ata filmojnë dhe raportojnë për ngjarjet që janë të rëndësishme për ta, montojnë filmimet e regjistruara, dhe i përbahen aftësi profesionale të vlefshme për emisionin. Si pjesë e një lëvizje kombëtare që është konsideruar si një burim legjitim informacioni, vetëbesimi tek këta të rinj rrit, gjithashtu, ndërgjegjësimin e tyre lidhur me faktin se ata mund të sjellin ndryshimin.



Reporterët e rinj duke realizuar një episod të emisionit Troç.

Nuk janë vetëm të rinjtë të cilët përfitojnë nga realizimi i emisionit. Fakti se 44% e popullsisë e ndjekin atë tregon se ai është një ndër programet më popullore në televizion. Mundësia për t'i mesuar dhe për t'i lënë të rinjtë të tregojnë ndodhitë e tyre do të ketë ndikime influencuese mbi gazetarinë në Shqipëri. Këta të rinj, të cilët së shpejti do kërkojnë të bëjnë karrierë në fushën e medias, do të vendosin standarte të larta për mënyrën se si shpërndahet informacioni në këtë vend. Troç-i e arrin këtë nëpërmjet ngritjes së çështjeve serioze dhe nëpërmjet krijimit të një kulture tek shqiptarët të cilët dallojnë saktësisht atë së çfarë kërkojnë nga televizioni.

"Edhe një vizitë në studion në Tiranë ku krijohet Troç-i vërteton se sa i suksesshëm është emisioni," shprehet Catharine, "Miq të të rinjve të Troç-it dhe ata që u intervistuan për emisionin mbushin ambientet e brendshme të studios. Ata sillen të gjithë mirë pasi janë të interesuar për të parë se si krijohet emisioni". Një projekt i shkallës së gjërë si Troç-i kërkon mbështetjen e financuesve, të cilët aktualisht përbëhen, ndër të tjera, nga Agjensia Norvegjeze për Zhvillim e Bashkëpunim (NORAD). Për të ruajtur një program të qëndrueshëm, janë trainuar edhe kordinatorët në mbledhjen e fondeve.

Është llogaritur që për të vazhduar Troç-in nevojiten \$2,500 për secilën nga zyrat në 11 qytete të Shqipërisë. Moderatorët e rritur shërbejnë si avokatë për emisionin dhe kërkojnë mbështetje nga organizatat dhe shoqatat vendore shqiptare. Ideja është se filantropistët shqiptarë do të marrin zotërimin e përbashkët të një projekti që është i veçantë për Shqipërinë, në vend që të financohet nga organizatat ndërkombëtare.

Pejsazhi i gazetarisë elektronike po ndryshon në Shqipëri dhe po kështu po ndodh edhe me çështjet që ai trajton. Falë programit Troç të mbështetur nga UNICEF-i, të rinjtë flasin dhe dëgjohej në një emision televiziv që është origjinal, i mprehtë dhe asgjë tjetër, përveçse e folur hapur.

## Fëmijët shqiptarë shfaqin krijimtari në kalendarin e tyre të vitit 2006



Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli dhe Përfaqësuesja e UNICEF-it Carrie Auer bashkë me fëmijët të pranishme në projektin e përshkrimit të fotografive

të një sistemi më të fortë për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri.

"Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se duhen bërë përpjekje më të forta për të promovuar pjesmarrjen e fëmijëve në familje, shkollë dhe në jetën sociale duke përfshirë lirinë e mendimit dhe të shprehjes, e cila është e domosdoshme në një shoqëri demokratike" shprehet Carrie Auer, përfaqësuese e UNICEF-it. jep mundësi të pakta për të shprehur opinionet apo të shprehin krijimtarinë e tyre. Ekspozita shërbeu edhe për të dhënë mbështetje në favor të një sistemi më të fortë për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri.

"Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se duhen bërë përpjekje më të forta për të promovuar pjesmarrjen e fëmijëve në familje, shkollë dhe në jetën sociale duke përfshirë lirinë e mendimit dhe të shprehjes, e cila është e domosdoshme në një shoqëri demokratike" shprehet Carrie Auer, përfaqësuese e UNICEF-it. says Carrie Auer, UNICEF representative.

## Parlamenti Rinor dhe Troç diskutojnë vlerat e kulturës shqiptare

UNICEF-i, Fondacioni Butrinti, Parlamenti Rinor dhe Troç-i diskutuan së fundi së bashku duke nxjerrë e shkëmbyer ide e mendime lidhur me mënyrat për ta bërë kulturën tradicionale shqiptare më tërheqëse dhe më të përdorshme nga të rinjtë. Kur u pyetën se çfarë kuptimi ka kultura për ta, të rinjtë dhanë përgjigje të ndryshme.

“Për mua, kultura është një lidhje dhe një mënyrë e jetesës që i mban njerëzit të bashkuar” shprehet Blerina, një parlamentare e re. “Kultura është një përbërës esencial mbi të cilën janë ndërtuar jetët e njerëzve”.

“Kultura është e kundërta e injorancës,” komenton Taulanti, një tjetër i ri shqiptar. Megjithatë, pavarësisht një vendi të pasur në thesare natyrore, kulturore dhe historike, të rinjtë janë kryesisht të paqartë rreth asaj se çfarë ka për t’u ofruar Shqipëria. Vendbanimet e lashta të gurta të Butrintit, Festivali Popullor i Sofrës Dardane, dhe shkrimet e vëllezërve Frashëri shpesh eklipsohen nga këngët më të fundit hip hop apo nga filmat.

Të rinjtë shqiptarë sot janë të etur për kulturë. Shumë prej tyre kanë lindur në fazën e fundit të komunizmit, një periudhë prej 45 vitesh të izolimit dhe të shtypjes kulturore. Sot media e huaj nga Europa Perendimore dhe Amerika vershon në vend, dhe për pasojë trashëgimia kulturore pothuajse nuk vihet re nga brezat e rinj.

“Unë di më shumë rreth asaj se çfarë është përtej detit Adriatik se sa di për vendin tim,” thotë Endri Shabani, Kryetar i Parlamentit Rinor Shqiptar.

Nuk është arsyeja se të rinjtë janë të painteresuar në trashëgiminë e vendit të tyre, u shprehen të rinjtë shqiptarë, por nuk ka informacion të disponueshëm. Mbulimi i kulturës vendore nga ana e medias është pothuajse inekzistent. Në shkollë mësohet pak lidhur me shtetësinë dhe çfarë do të thotë të jesh shqipëtar. Për më tepër, kushtet e vështira të transportit nëpër Shqipëri nuk krijon mundësi që pikat turistike të shfrytëzohen nga njerëzit, sidomos nga të rinjtë të cilat kanë më pak mundësi për të disponuar automjete.

Rrjedhimisht të rinjtë nga rajone të ndryshme të Shqipërisë kanë vështërsi për të kuptuar njëri-tjetrin. Ato tradita që i janë transmetuar të rinjve janë kryesisht të kufizuara në ato zona ku ata janë rritur. “Dallimet kulturore në Shqipëri janë shpesh shaku i keqkuptimeve dhe konflikteve ndërmjet të rinjve,” thotë Juliana, një studente në Tiranë.

“Për arsye të ndryshmeve që ekzistojnë ndërmjet zakoneve rajonale, Shqipëria nuk ka qenë asnjëherë një komunitet i bashkuar,” komenton Taulanti, “Të rinjtë mund të mësojnë për këto tradita unike për të bashkuar Shqipërinë si komunitet.”

Megjithëse të rinjtë në procesin e shkëmbimit dhe të nxjerresës së ideve pranuan se mundësia për të hyrë në kulturën shqiptare është e rëndësishme për të rinjtë. Një i ri vërejt, “Kultura është influencë pozitive sepse ajo mund t’i bashkojë të rinjtë.”

Dija për kulturën Shqiptare ka potencialin të krijojë një sens bashkimi në një vend që ka një shumëlloshmëri karakteresh dhe zakonesh. Të rinjtë nga të gjitha pjesët e Shqipërisë mund të kënaqen duke vizituar vende kulturore si Butrinti, Apollonia, Gjirokastrë, Shkodra, Kruja dhe Kukësi. Me anë të takimit me njerëz të tjerë dhe shkëmbimit të traditave nga këto rajone, të rinjtë do të mësojnë se ata bashkëndajnë një trashëgimi të përbashkët. Tej dhënies së një burimi për argëtim dhe edukim, e drejta për të hyrë në kulturën shqiptare do të kishte edhe përfitime të natyrës sociale.

“Me anë të njohjes së kulturës sonë të përbashkët shqiptarë” shprehet Blerina, “Kjo na lejon të vlerësojmë se kush jemi ne si komb, kështu që ne mund të punojmë për një të mirë më të madhe të njerëzve tanë dhe të botës.”

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit Shqipëria ka hapur dyert e saj për bashkësinë ndërkombëtare. Marrveshja e Asociimit dhe Stabilizimit, aktualisht në proces bisedimesh, do ta sjellë Shqipërinë më pranë objektivit të saj të integritetit në Bashkimin Europian. “Për të qenë në gjendje për t’u integruar në mënyrë të suksesshme në një komunitet shumë-kulturësh siç është BE-ja” thotë Juliana, “Shqiptarët duhet të dinë, të kuptojnë dhe të vlerësojnë kulturën e tyre.”

Të rinjtë presin që Shqipëria të luajë një rol domethënës në bashkëndarjen e vlerave të komunitetit global. Si vendim marrës të ardhshëm të Shqipërisë, të rinjtë kuptojnë se është me rëndësi jetike të kenë mundësi të mësojnë rreth trashëgimisë së tyre dhe të marrin pjesë në kulturën e pasur dhe të larmishme të Shqipërisë.

Sesioni i shkëmbimit dhe i nxjerrjes së ideve ishte i frytshëm. Të rinjtë u zotuan të veprojnë në përkrahje të të mësuarit nga përvojat dhe “drejtpërdrejt” në mënyrë që ta bëjnë edukimin kulturor më tërheqës dhe më të mundshëm për t’u përdorur nga të rinjtë në Shqipëri. Të rinjtë planifikojnë të promovojnë rëndësinë e edukimit kulturor me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si edhe me fondacionet dhe vendet historike rreth Shqipërisë.

“E gjithë kjo është për të thënë kush jemi ne,” shprehet Blerina, “Pa kulturën tonë, ne nuk do të ishim Shqipëtarë!”

**“Unë kam shpresë të madhe  
Tek Zoti  
se ai nuk do ta braktisë  
Shqipërinë, kështu,  
Por që ajo do të ndrisë  
Dhe do të lulëzojë”**

- Naim Frasheri, nga poema e tij Shpresa

Për informacion të mëtejshëm ju lutemi kontaktoni me:

UNICEF  
Rruga Skënderbej, Godina Volkswagen, Kati i 3të  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon: 355.4.273.335  
Facsimile: 355.4.243.775  
E-mail: Tirana@unicef.org  
Website: www.unicef.org/albania

unicef    
1 9 4 6 - 2 0 0 6